



Informacione për kurse me fillim që nga data 1.4.2019

Mësoni gjermanisht - ja vlen!


Federata dhe kantoni përkrahin persona me vendbanim në kantonin St.Gallen në pjesëmarrjen e një kursi alfabetizimi ose gjermanishteje deri në nivel B2.

Ju keni të drejtë të merrni zbritje në masën **Fr. 8.- për mësimet të alfabetizimit dhe Fr. 7.- për mësimet të gjermanishtes**, nëse plotësoni këto kushte:

- Ju e keni vendbanimin tuaj brenda kantonit St. Gallen
- Të ardhurat tuaja janë më pak se Fr. 40'000.– për persona të vetëm, ose më pak se Fr. 55'000.– për çifte martesore dhe familje
- Për persona me detyrim për tatimin në burim dhe për persona pa vlerësim tatimor llogariten 75 përqind të të ardhurave vjetore bruto si të ardhura të tatueshme
- Pasuria juaj e tatueshme është më pak se Fr. 50'000.–
- Ju keni një kartë identiteti për të huaj B, C, L ose e keni nënshtetësinë zvicerane
- Kursi juaj nuk paguhet nga asnjë ent tjetër (p.sh. Zyra e Çështjeve Sociale, RAV, AHV-IV Enti i Pensioneve, SUVA, punëdhënësi/punëdhënësja)
- Ju duhet të merrni pjesë në kurs për të paktën 80 përqind
- Me efekt në të shkuarën, domethënë pas përfundimit të një kursi, zbritjet nuk mund të shpërblehen më

Nëse i plotësoni kushtet dhe nëse kërkesa juaj miratohet, shkolla e gjuhëve ka të drejtë, t'ju faturojë shpenzime të zbritura për kursin. Zbritjet mund të merren tek shkolla të ndryshme të gjermanishtes të akredituara nga kantoni.

Për një regjistrim zgjidhni një [shkollë të akredituar](#) prej listës dhe mbusheni bashkë me shkollën [kërkesën](#) për marrjen e zbritjeve për kursin. Shkolla, me miratimin tuaj, do t'ia transmetojë këtë Zyrës për Çështje Sociale. Me shumë informacione gjeni në faqen e internetit të kantonit nën: www.deutschkurse.sg.ch.





Amt für Soziales

Kompetenzzentrum Integration und Gleichstellung

Rrjedhja për marrjen e zbritjeve



1. Pjesëmarrësit në kurse (KTN) regjistrohen pranë një shkolle.
2. KTN-të e vërtetojnë kundrejt shkollës së gjuhëve dhe kundrejt Zyrës për Çështje Sociale (AfSO) plotësimin e kushteve.
3. Kërkesa nga shkolla e gjuhëve i transmetohet AfSO-së nëpërmjet e-mailit.
 - ➔ Kërkesa mund të parashtrohen në çdo kohë. Por duhet të jetë para përfundimit të kursit.
 - ➔ Pranohen vetëm kërkesa, për të cilat përdoret formulari zyrtar i kërkesave i AfSO-së.
4. Aprovimi i kërkesës përmes AfSO-së brenda tri javësh (hyrja e e-mailit). Shollat e gjuhëve janë lutur, të presin me faturimin për këto tri javë.
 - ➔ Me efekt në të shkuarën, domethënë pas përfundimit të kursit, zbritjet nuk mund të kërkohen më.
5. AfSO-ja ia ruan vetes, të verifikojë të dhënat e KTN-ve dhe për këtë të kërkojë transmetimin e dokumenteve.